



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr

**VENDIM
PËR FORMIMIN E GRUPIT DREJTUES**

**Neni 1
Përbërja**

Me këtë Vendim formohet grupi drejtues për zbatimin e programit për vendosjen e rendit komunal për shërbime publike në Komunën e Lipjanit i cili projekt do të përkrahet nga Demos (në vazhdim të tekstit grupi drejtues) në përbërje si vijon:

- 1.Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, Kryesues
- 2.Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese e Kuvendit Komunal, anëtare
- 3.Imer Rrustemi, Drejtor i Drejtoratit për Inspeksion, anëtar
- 4.Heset Sahiti, Drejtor i Drejtoratit për Shërbime Publike, anëtar

**Neni 2
Rolet dhe përgjegjësitë e grupit drejtues**

- Mbikëqyrë dhe validon drejtimin e përgjithshëm të projektit të zbatimit të ligjit/vendosjes së rendit komunal;
- Miraton raportet, pilot iniciativat dhe rezultatet tjera të përgatitura nga grupi punues në bashkëpunim me DEMOS-in;
- Monitoron punën e grupit punues dhe progresin e projektit;
- Merr vendime në pika kyçe gjatë zbatimit të projektit;
- Vendos për ndarjen e buxhetit gjatë rrjedhës së projektit apo gjatë planifikimit të buxhetit apo Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) (nëse është e nevojshme).

Shpeshtësia e takimeve:

- Çdo dy muaj apo sipas nevojës nëse ka çështje apo vendime që duhet të merren

**Neni 3
Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e Grupit drejtues si dhe autoritetet e Demos.

1Nr. 112-46106
Lipjan, më 19.08.2016

